

URDHËR
Nr. 27, datë 24.2.2015

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR VERIFIKIM
DHE KONTROLLIN E SIPËRFAQES SHETËTËRORE DHE PRIVATE NË TË
GJITHË ZONËN BREGDETARE QË PËRFSHIHET NË TERRITORIN E BASHKIVE
VLORË, HIMARË, SARANDË DHE KONISPOL**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për verifikimin dhe kontrollin e sipërfaqes shetëtorre dhe private në të gjithë zonën bregdetare që përfshihet në territorin e bashkive Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol.

2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ketë në përbërje anëtarë:

- 3 përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- 3 përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra përkatëse vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- 1 përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
- 1 përfaqësues nga Task – Forca për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shetëtorre;
- 3 përfaqësues nga ALUIZNI, qendror dhe vendor;
- 1 përfaqësues nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- 1 përfaqësues nga Prefektura Vlorë;
- 1 përfaqësues nga Bashkia Vlorë;
- 1 përfaqësues nga Bashkia Himarë;
- 1 përfaqësues nga Bashkia Sarandë;
- 1 përfaqësues nga Bashkia Konispol.

3. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë, brenda 5 (pesë) ditëve, emrat e personave përfaqësues pranë kryetarit të grupit të punës.

4. Detyrat kryesore të grupit ndërinstitucional të punës janë:

- Verifikimi i sipërfaqeve shetëtorre e private brenda zonës bregdetare, të cilat përfshihen në territorin e bashkive Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol;
- Identifikimi i zonave informale dhe kërkesat për legalizim brenda këtyre sipërfaqeve.

5. Grupi ndërinstitucional i punës, për përmbushjen e detyrave të ngarkuara, të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin ekzistues dhe atë që do t’u vihet në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, të kryejnë vizitat në terren dhe të bashkërendojnë punën me të gjitha institucionet shetëtorre që lidhen me këtë veprimtari.

6. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës, që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të përfundojë detyrën e ngarkuar dhe t’i paraqesë Kryeministrit materialin e përgatitur sipas përcaktimeve të pikave 4 e 5, të këtij urdhri.

7. Ngarkohet kryetari i grupit ndërinstitucional të punës për njoftimin e anëtarëve për mbledhjen e parë të këtij grupi.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për koordinatorimin ndërinstitucional për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama